



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 533 Prot.

Roskovec, më 29.01 2020

VENDIM

Nr. 3 datë 24/01 /2020

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË
TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE, NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI
6% PËR BLOK-NDIHMËN PËR VITIN 2020**

Në mbështetje të ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Nenit 21 të Ligjit Nr. 57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, dhe në pikën 1, të Kreut IV të Vendimit Nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- Miratimin e kriterëve për trajtimin e familjeve që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit, për vitin 2020 si më poshtë:
 - Familjet të cilat kanë aplikuar për ndihmë ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur fitues nga sistemi i pikëzimit.
 - Familjet të cilat përzgjidhen për tu trajtuar me këtë fond duhet të jenë verifikuar paraprakisht nga zyra e ndihmës ekonomike.
 - Familjet e përzgjedhura duhet të jenë familje në nevojë, të jenë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
 - Familjet ku kryefamiljari ose dhe anëtarë të tjerë madhorë, të cilët janë të paafte për punë por për shkak të legjislacionit në fuqi nuk përfitojnë pagesën e paafte-sisë.
 - Familjet me prindër të divorcuar me të paktën një fëmijë në arsimin bazë ose të lartë.
 - Familjet me kryefamiljar vajzat nëna dhe gratë e veja.
- Ngarkohet sektori i Shërbimit Social për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Hyska

